



 REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E DIASPORËS / MINISTRY OF DIASPORA / MINISTARSTVO ZA DIJASPORU			
Njësia Org. Org. Jedin. Org Unit	01	Nr. Prot. Br. Prot Prot.No.	264
Nr. i faqeve Broj stranica No. pages	01	Data Datum: Date:	31, 12, 12
Prishtinë / a			



Republika e Kosovës
Qeveria e Kosovës
MINISTRIA E DIASPORËS

Marrëveshje

Në mes palëve:

1. UBT me numër të regjistrimit të biznesit 70325441 të cilën e përfaqëson, Prof. Dr. Edmond Hajrizi - Presidenti, dhe
2. Ministria e Diasporës së Republikës së Kosovës, të cilën e përfaqëson Z. Ibrahim Makolli – Ministër në Ministrinë e Diasporës së Republikës së Kosovës.

Neni 1

Objekt i kësaj marrëveshje është zhvillimi i Sistemit të Informacionit për Diasporën nga ana e UBT-së për Ministrinë e Diasporës së Republikës së Kosovës.

Neni 2

UBT merr për obligim që të zhvillojë Sistemin e Informacionit për Diasporën, i cili do t'i dorëzohet Ministrisë së Diasporës, katër muaj pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje.

Sistemi i Informacionit për Diasporën do të përmbajë:

1. Regjistrimin e shoqatave të komunitet;
2. Regjistrimin e kompanive;
3. Regjistrimin e veprimtarive të personave;
4. Regjistrimin e veprimtarive akademike;
5. Moduli i raporteve, si dhe
6. Sistemi mund të plotësohet me aneks kontratë sipas nevojës.

Neni 3

Zhvillimi i Sistemit të Informacionit për Diasporën për Ministrinë e Diasporës do të jetë donacion nga UBT në vlerë prej 75 680 Euro.

Instalimi i infrastrukturës harduerike do të bejë Ministria e Diasporës.

Mirëmbajtja dhe trajnimi i stafit të Ministrisë së Diasporës në afatin 12 mujor do të realizohet nga UBT e cila mund të vazhdohet sipas nevojës.

Ministria e Diasporës do të mbulojë shpenzimet për trajnim të stafit.

Neni 4

E drejta autoriale e Sistemit të Informacionit për Diasporën të zhvilluar për Ministrinë e Diasporës, mbetet në pronësi të UBT-së në përputhje me kondiktat ligjore të parapara për të drejtën autoriale, ndërsa përdorimi i këtij Sistemi mund të bëhet nga ana e Ministrisë së Diasporës.

Neni 5

UBT-së i lejohet që të përdorë të dhënat nga Ministria e Diasporës në Sistemin e Informacionit për Diasporën për qëllime studimore, analiza, hulumtime, raporte, etj.

Neni 6

Mosmarrëveshjet eventuale do të zgjidhen në frymen e parimit Bona fides, ndërmjet përfaqësuesve të palëve nënshkruese.

Neni 7

Në rast se palet nuk arrijnë të tejkalojnë mosmarrëveshjet eventuale, kompetente është njëra nga Gjykatat në territorin e Republikës së Kosovës.

Neni 8

Kjo marrëveshje është përpiluar në katër kopje identike, ku palet marrin nga dy (2) kopje.

UBT

Presidenti

Pro. Dr. Edmond Hajrizi




Ministria e Diasporës së Republikës së Kosovës

Ministri

Z. Ibrahim Makolli

